

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar, Afrim Shala dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Sh.J., nga fshati ..., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale zjarrvënia, nga neni 334 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1323/2015, të datës 22 Janar 2018, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, P.nr.272/2016, të datës 8 Nëntor 2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 10 Prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, P.nr.272/2016, i datës 8 Nëntor 2017, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, me aktgjykimin e lartcekur, të akuzuarin Sh.J., nga fshati ..., Komuna e Malishevës, në bazë të nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP) e ka liruar nga akuza për shkak të veprave penale zjarrvënia, nga neni 334 paragrafi 1 të KPRK dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK, sepse nuk është vërtetuar se i akuzuar i ka kryer këto vepra penale.

Shpenzimet e procedurës penale është vendosur që të bien në llogari të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ankesë brenda afatit ligjor ka paraqitur Prokuroria Themelore në Gjakovë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit për lirim nga dënimi, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPA/II.nr.186/2018, të datës 23 Shkurt 2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtojë shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPP dhe vlerësoj pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, konstatoi se :

- ankesa është e pabazuar.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike kur ka vendosur që ta liroj nga akuza të akuzuarin Sh.J., për shkak të veprave penale të lartcekura. I akuzuari Sh.J., në mbrojtjen e tij, kishte deklaruar se nuk është e vërtetë se e ka kallur sanën, pasi që atë ditë ka shkuar me pa babain e tij në Prishtinë dhe në Prishtinë ka punuar deri në ora 17:30 minuta, kur është kthyer në shtëpi, ku edhe është njoftuar nga nëna e tij se kanë qenë policia. Në ankesë, më tej shtohet se gjykata e shkallës së parë gabimisht ja ka falur besimin mbrojtjes së të akuzuarit, i cili e ka mohuar kryerjen e këtyre veprave penale, me arsyetim se nuk ka asnjë provë tjetër mbështetëse e cila do të vërtetonte dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari i ka kryer veprat penale të lartcekura. Sa i përket alibisë së të akuzuarit, në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, theksohet se i akuzuari nuk ka ofruar asnjë provë që do të vërtetonte se ditën kritike ka qenë në Prishtinë për të vizituar babain e tij në Qendrën Klinike Universtitare të Kosovës dhe për të punuar. Sa i përket dëshmimeve të dëshmitarëve E.K. dhe F.K., të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata gabimisht ja ka falur besimin se gjoja i akuzuari ka punuar në Prishtinë pa specifikuar vendin e punës ku kanë punuar, pasi deklaratat e tyre janë në kundërshtim me provat tjera që janë administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në veçanti me deklaratat e të dëmtuarit H.J. dhe dëshmitarëve S.J. dhe G.J., të cilët pothuajse në mënyrë identike kanë përshkruar ngjarjen, duke theksuar se zjarri është nisur nga ara e të akuzuarit dhe kjo sipas të dëmtuarit është bërë me qëllim që të ndizet edhe parcela e të dëmtuarit. Në fund, në ankesë theksohet se me rastin e marrjes së vendimit për lirim nga akuza për të akuzuarin Sh.J., gjykata e shkallës së parë e ka shkelur ligjin penal dhe ka tejkalluar kompetencat ligjore, duke e zbatuar ligjin në favor të të akuzuarit, edhe pse ka patur prova të mjaftueshme dhe bindëse për ta shpallur fajtor dhe për ta dënuar për veprat penale për të cilat është akuzuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë janë të pabazuara. Gjykata e

shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe se me rastin e vendosjes së kësaj çështje juridike penale dhe marrjes së aktgjykimit nuk është shkelur ligji penal në favor të të akuzuarit. Në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë ka administruar një sërë provash, siç janë : marrjen në pyetje të të dëmtuarit H.J., dëgjimin e dëshmitarëve E.K., F.K., S.J. dhe G.J., marrjen në pyetje të të akuzuarit Sh.J. dhe provat materiale. Pas administrimit të të gjitha këtyre provave, gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka liruar nga akuza të akuzuarin, ngase, edhe Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuar Sh.J. ta ketë kryer këtë veprë penale.

Nga shkresat e lëndës, shihet se i akuzuari Sh.J. i kishte mohuar kryerjen e veprave penale për të cilat ishte akuzuar, duke pretenduar se ditën kritike kishte qenë në Prishtinë se bashku me dëshmitarët F.K. dhe E.K. deri në ora 17:30 minuta. Me rastin e kthimit në shtëpi, nëna e tij e kishte njoftuar se kishin qenë policia dy herë brenda ditës, arsyen e së cilën nuk e kishte ditur nëna e tij.

Fakti se ditën kritike i akuzuari kishte qenë në Prishtinë gjen mbështetje edhe në deklaratimet e dëshmitarëve F.K. dhe E.K., të cilët e kishin pohuar këtë fakt. Në anën tjetër, edhe vetë dëshmitarët S.J. dhe G.J., gjatë marrjes në pyetje në shqyrtim gjyqësor kishin deklaruar se ditën kritike kur e kishin vërejtur zjarrin, nuk e kishin parë të akuzuarin Sh.J. atë ditë tek ara e tij. Andaj, gjykata e shkallës së parë ja kishte falur besimin deklaratimit të të akuzuarit Sh.J., për shkak se ky deklaratim gjen mbështetje edhe në dëshmitë e dëshmitarëve F.K. dhe E.K., si dhe deklarimi i të akuzuarit nuk është në kundërshtim as me dëshmitë e dëshmitarëve S.J. dhe G.J., të cilët kishin deklaruar se ditën kritike kur kishtin vërejtur zjarrin nuk e kishin parë të akuzuarin. Kështu, që edhe pretendimi ankimor i Prokurorisë Themelore në Gjakovë në këtë aspekt është i pabazuar.

Sa i përket deklaratimit të të dëmtuarit H.J., gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk ja kishte falur besimin, për shkak se deklarimet e tij ishin në kundërshtim me deklarimet e mëparshme të dhëna në polici dhe në prokurori sa i përket disa fakteve të cilat janë vlerësuar si fakte relevante dhe se deklarimet e tij janë vlerësuar si subjektive dhe kontradiktore, për shkak të raporteve jo të mira familjare me të akuzuarin.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura dhe provave materiale, gjykata e shkallës së parë e kishte liruar nga akuza të akuzuarin Sh.J., duke e respektuar edhe parimin "*in dubio pro reo*", për shkak se nuk është vërtetuar se i njëjti i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur të akuzuarin Sh.J. e ka liruar nga akuza, për shkak se me të vërtetë nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, kështu që në këtë drejtim gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, si dhe nuk është shkelur ligji penal në favor të të akuzuarit. Andaj, edhe në këto drejtime, pretendimet e Prokurorisë Themelore në Gjakovë janë të pabazuara.

Në anën tjetër, meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtojë aktgjykimin e ankimuar edhe në këtë drejtim dhe konstatojë se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, konkret dhe nuk përmban kundërthënie me vet veten e as me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara apo si të pa provuara. Njëherit, gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto përfundimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë dhe në bazë të neni 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.173/2018, Më 10 Prill 2018

Procesmbajtësi,
Bajram Rexhahmetaj

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala
Shqipe Qerimi

Kryetari i kolegjit,
Gani Zabeli